



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 52 (827957)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E mërkurë, 31 dhjetor 2025



» faqe 2-3

BETIMI QË LIDH FJALËN ME ATDHEUN



MIRËNJOHJE QË FORCON MISIONIN

Një nismë me vlerë institucionale dhe njerëzore
Në kuadër të kujdesit të vazhdueshëm për personelin e Forcave të Armatosura dhe familjet e tyre, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, ndërmoi një vizitë të posaçme në Novo Selo, ku efektivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë shërbejnë në mision ndërkombëtar. Kjo vizitë u shoqërua nga një udhëtim i organizuar për familjarët e efektiveve, prindër, bashkëshortë dhe...

» faqe 4



KOMANDA MBËSHTETËSE 18 VITE NË FORMATIN E RI, 78 VITE HISTORI SHËRBIMI

Komanda Mbështetëse, një nga strukturat më të rëndësishme dhe jetike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, shënon 18 vjet funksionim në formatin e saj aktual, duke mbartur njëkohësisht një trashëgimi historike që nis në vitin 1947. Ky përvjetor përbën një moment reflektimi...

» faqe 8



URIMI, FESTA DHE SHPRESA: NGA VITET '90 DERI NË 2025, NJË UDHËTIM PSIKOLOGJIK DHE SHOQËROR I SHPIRTIT SHQIPTAR

Në fund të çdo viti, njeriu ndalet. Jo sepse koha ndalon, por sepse ndërgjegjja e kërkon këtë ndalesë. Është një çast reflektimi, një pauzë e domosdoshme përpara se të vazhdohet marshimi përpara. Në këtë ndalesë, njeriu sheh pas shpine barrën e muajve të kaluar, peshon humbjet dhe fitoret, numëron...

» faqe 9



BETIMI QË LIDH FJALËN ME ATDHEUN

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

387 rekrutë, kadetë dhe studentë hedhin hapin e parë në shërbim të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

Një ceremoni solemne, e mbushur me emocion, krenari dhe përgjegjësi të lartë kombëtare, shënoi betimin ushtarak të 387 të rinjve dhe të rejave rekrutë, kadetë dhe studentë, të cilët zyrtarisht u rreshtuan në radhët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ky akt solemn përbën jo vetëm nisjen e shërbimit ushtarak, por edhe një zotim të shenjtë për besnikëri ndaj flamurit, kombit dhe Republikës.

Ceremonia u zhvillua në prani të **Presidentit të Republikës dhe Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Bajram Begaj, ministrit të Mbrojtjes, Pirro Vengu, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjenerallejtënant Arben Kingji,** si dhe drejtuesve të lartë ushtarakë, instruktorëve, pedagogëve, familjarëve të ushtarakëve të rinj dhe të ftuarve të tjerë.

Një ditë e shënuar për Forcat e Armatosura dhe për Shqipërinë

Në një atmosferë solemne dhe dinjitoze, të rinjtë shqiptarë shqiptuan fjalët e betimit ushtarak mbi flamur, duke marrë mbi supë barrën fisnike të mbrojtjes së sovranitetit, integritetit territorial dhe interesave kombëtare të vendit.

Ky moment shënon një gur themeli në formimin e tyre profesional dhe moral si ushtarakë të Forcave të Armatosura, por njëkohësisht përfaqëson edhe një investim strategjik në të ardhmen e sigurisë kombëtare.

Të pranishëm në ceremoni ishin gjithashtu **kadedë dhe studentë nga Kosova**, të cilët po formohen sipas të njëjtave standarde profesionale dhe vlera euroatlantike, duke kontribuar në forcimin e bashkëpunimit, besimit dhe ndërveprueshmërisë rajonale.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji: Fjala e dhënë bëhet mision për gjithë jetën

Mesazhe me peshë dhe përgjegjësi të lartë përcolli edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të



Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili theksoi se betimi ushtarak është një akt që shkon përtej momentit solemn dhe shndërrohet në një mision jetësor.

“Ky akt mbart një peshë që zgjat gjithë jetën. Nga ky çast, fjala e dhënë nuk është thjesht premtim, por detyrim, përgjegjësi dhe mision, për t’i shërbyer me besnikëri Republikës së Shqipërisë, për të qenë të guximshëm, të disiplinuar dhe të denjë për uniformën ushtarake”, – u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Ai theksoi se për **ushtarët e rinj**, ky betim kurorëzon javë të tëra përkushtimi, stërvitjeje intensive dhe përshtatjeje me jetën ushtarake, ndërsa për **studentët dhe kadetët**, ai përfaqëson bashkimin e dijës profesionale me karakterin dhe disiplinën, duke e shndërruar formimin akademik në përgjegjësi konkrete ndaj Atdheut.

Gjenerallejtënant Kingji nënvizoi se Forcat e Armatosura kërkojnë njerëz të përgatitur jo vetëm

fizikisht dhe profesionalisht, por edhe moralisht, të aftë për të përballuar sfidat e kohës dhe për të vepruar me vendosmëri në mbrojtje të interesave kombëtare.

Presidenti Bajram Begaj: Betimi ushtarak është zotimi më i madh që një qytetar i bën atdheut

Në fjalën e tij përshëndetëse, Presidenti i Republikës uroi ushtarakët e rinj për nisjen e këtij rrugëtimi fisnik, duke theksuar se shërbimi ushtarak është nder, krenari dhe përgjegjësi e lartë kombëtare.

“Sot është një ditë e veçantë për ju. Betimi ushtarak është një akt solemn, një zotim i qartë përpara flamurit dhe kombit, një premtim që shoqëron çdo ushtarak gjatë gjithë jetës së tij. Është zotimi më i madh që çdo qytetar mund t’i bëjë atdheut të vet”, – u shpreh Presidenti Begaj.

Ai theksoi se mbi supet e ushtarakëve të rinj bie barra e rëndë, por shumë fisnike, e mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, duke nënvizuar se

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”



ata përfaqësojnë shpresën dhe forcën morale të institucionit të mbrojtjes.

Presidenti vlerësoi procesin e stërvitjes dhe formimit, gjatë të cilit të rinjtë kanë ndërtuar disiplinën, karakterin dhe bindjen se shërbimi ndaj atdheut është i shenjtë.

Siguria nuk është e mirëqenë: Sfidat e reja gjeopolitike

Duke iu referuar zhvillimeve ndërkombëtare, Presidenti Begaj vuri theksin te situata e sigurisë në Europë dhe rajon, duke theksuar se paqja dhe siguria nuk mund të merren si të mirëqena.

“Lufta e Rusisë në Ukrainë ka vënë në pikëpyetje sigurinë europiane. Bota po përballë me sfida të reja nga aktorë që nuk ndajnë vlerat e lirisë dhe demokracisë. As rajoni ynë nuk është i izoluar nga këto zhvillime”, – theksoi ai.

Presidenti nënvizoi rëndësinë strategjike të stabilitetit të Ballkanit Perëndimor, veçanërisht rolin e Kosovës, dhe kujtoi se si anëtare e NATO-s, Shqipëria ka jo vetëm përfitime, por edhe detyrime. Forcat e Armatosura shqiptare, sipas tij, kanë dëshmuar profesionalizëm dhe besueshmëri përmes kontributit aktiv në misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së.

Ministri Pirro Vengu: Fuqia luftarake ndërtohet mbi kapitalin njerëzor

Në fjalën e tij drejtuar ushtarakëve të rinj, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vlerësoi vendimin e tyre vullnetar për t'u bashkuar me Forcat e Armatosura në një kontekst sfidues për sigurinë rajonale dhe evropiane. Ai theksoi se fuqia e një ushtrie nuk matet vetëm me teknologji dhe pajisje, por mbi të gjitha me njerëzit që e përbëjnë atë: karakterin, disiplinën, profesionalizmin dhe aftësinë për të vepruar nën presion.

“Arsimi ushtarak është themeli i forcës së Forcave të Armatosura. Ushtria që kërkon NATO dhe që meriton Shqipëria ndërtohet mbi njerëz të përgatitur dhe struktura funksionale”, – u shpreh ministri Vengu.

“Mbrojtja 2030” – vizioni për një ushtri moderne dhe të besueshme

Ministri Vengu nënvizoi se Programi Strategjik “Mbrojtja 2030” mbështetet mbi dy shtylla themelore:

- **Kapitalin njerëzor,**
- **Infrastrukturën kritike dhe kapacitetet operacionale**

Ai theksoi se investimet në Akademinë e Forcave të Armatosura, qendrat stërvitore, laboratorët, poligonet dhe sistemet moderne të trajnimit nuk janë luks, por domosdoshmëri për ndërtimin e një ushtrie moderne, të ndërveprueshme me aleatët dhe të besueshme për qytetarët.

Në përmbyllje, ministri theksoi se sot Forcat e Armatosura janë më shumë se një ushtri: ato janë shtyllë e mbrojtjes kombëtare, përfshirë dimensionin kibernetik, si dhe një rezervë strategjike e kapitalit njerëzor për qëndrueshmërinë e vendit.



Një betim për Atdheun, një vokacion për jetën

Gjatë ceremonisë, 387 të rinjtë dhe të rejat u betuan për besnikëri ndaj Republikës së Shqipërisë, duke shprehur angazhimin për të mbrojtur atdheun me nder, disiplinë dhe sakrificë.

Ky betim nuk premtion rehati, por **i jep kuptim jetës;** nuk garanton lehtësi, por **ndërton dinjitet;** nuk është thjesht një zgjedhje profesionale, por **një vokacion.**

Sot, këta të rinj janë garantët e besimit se **siguria, stabiliteti dhe e ardhmja e Shqipërisë** mbështeten mbi përkushtimin dhe profesionalizmin e Forcave të Armatosura.





Mirënjohje që forcon misionin

Një nismë me vlerë institucionale dhe njerëzore

Në kuadër të kujdesit të vazhdueshëm për personelin e Forcave të Armatosura dhe familjet e tyre, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, ndërmori një vizitë të posaçme në Novo Selo, ku efektivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë shërbejnë në mision ndërkombëtar. Kjo vizitë u shoqërua nga një udhëtim i organizuar për familjarët e efektiveve, prindër, bashkëshortë dhe fëmijë si shprehje mirënjohjeje për përkushtimin dhe sakrificën e tyre të vazhdueshme.

Nisma përfaqëson një qasje të konsoliduar institucionale, ku përkujdesja për familjen e ushtarakut konsiderohet pjesë përbërëse e forcimit të kapaciteteve morale dhe profesionale të trupave shqiptare në mision.

Forcat e Armatosura në mision:

Profesionalizëm dhe përgjegjësi

Angazhimi i Forcave të Armatosura të Shqipërisë në misione ndërkombëtare është dëshmi e qartë e rolit aktiv të vendit tonë në arkitekturën e sigurisë kolektive. Trupat shqiptare në Novo Selo përfaqësojnë standarde të larta profesionale, disiplinë operative dhe bashkëpunim efektiv me partnerët aleatë.

Në këtë kontekst, prania e familjarëve në bazën ku

shërbejnë efektivët solli një dimension të ri: **afërsinë njerëzore me realitetin e shërbimit ushtarak**, duke krijuar një urë komunikimi dhe mirëkuptimi ndërmjet misionit dhe jetës familjare.

Familja, shtyllë morale e efektivit

Pas çdo ushtaraku që shërben jashtë vendit,

qëndron një familje që përballon ndarjen, ankthin dhe pritjen. Prindërit që rriten me sakrificë bijtë dhe bijat e tyre, bashkëshortët që mbajnë mbi supe përgjegjësitë e përditshme dhe fëmijët që rriten me mungesën e prindit, janë pjesë e pandashme e këtij misioni.





Udhëtimi drejt Novo Selos u konceptua pikërisht për të:

- vlerësuar rolin e familjes në suksesin e misionit,
- forcuar mbështetjen morale për efektivet,
- rritur transparencën mbi kushtet e shërbimit.

Pamjet e takimeve, përqafimeve dhe komunikimit të drejtpërdrejtë dëshmojnë se morali i trupave rritet ndjeshëm kur familja bëhet pjesë e përjetimit të misionit.

Gjatë vizitës, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, theksoi se përkushtimi i efektiveve shqiptarë në misione ndërkombëtare është i lidhur ngushtë me mbështetjen që ata marrin nga familjet e tyre.

Ai nënvizoi se: "Forcat e Armatosura janë më të forta kur pas çdo efektivit qëndron një familje e mbështetur dhe e vlerësuar. Ky udhëtim është një shprehje respekti për sakrificën e përbashkët".

Ministri vlerësoi gjithashtu profesionalizmin e trupave në Novo Selo dhe rolin e tyre në forcimin e imazhit të Shqipërisë si një partner i besueshëm në misionet ndërkombëtare të sigurisë.

Novo Selo, realiteti i përditshëm i misionit

Baza ku shërbejnë trupat shqiptare në Novo Selo përfaqëson një mjedis operativ të ndërtuar mbi rregull, bashkëpunim dhe gatishmëri të lartë. Vizita e familjarëve u shoqërua me prezantimin e kushteve të jetesës dhe shërbimit, duke krijuar një panoramë më të qartë për realitetin e përditshëm të efektiveve.

Ky proces ndihmon në:

- uljen e pasigurive të familjarëve,
- rritjen e besimit ndaj institucionit,
- forcimin e lidhjes emocionale mes efektivit dhe familjes.

Një ushtri moderne, me fokus te njeriu

Forcat e Armatosura të Shqipërisë po konsolidojnë gjithnjë e më shumë modelin e një ushtrie moderne, ku zhvillimi profesional shoqërohet me kujdes social dhe njerëzor. Politikat e mbështetjes për familjet e ushtarakëve janë pjesë e strategjisë afatgjatë për rritjen e motivimit dhe qëndrueshmërisë morale të trupave.

Ky udhëtim për familjarët në Novo Selo përfaqëson një praktikë të mirë institucionale, e cila përforcon

ndjenjën e përkatësisë dhe përgjegjësisë kolektive.

Mesazh për të ardhmen

Iniciativa të tilla përcjellin një mesazh të qartë: shteti shqiptar vlerëson jo vetëm shërbimin e efektivit në terren, por edhe sakrificën e familjes së tij. Në një realitet ku angazhimet ndërkombëtare kërkojnë përgatitje të lartë dhe përballje me sfida komplekse, mbështetja morale mbetet një faktor kyç i suksesit.

Vizita në Novo Selo dhe udhëtimi i organizuar për familjarët e efektiveve përbëjnë një akt domethënës mirënjohjeje dhe respekti institucional. Ajo dëshmon se Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë një institucion që ndërton fuqinë e vet mbi profesionalizëm, disiplinë dhe vlera njerëzore. Sepse pas çdo misioni të suksesshëm, qëndron një sakrificë e përbashkët ajo e ushtarakut dhe e familjes së tij.





Ministri Vengu viziton trupat shqiptare në misionin e NATO-s në Bullgari: Vlerësim për togën shqiptare në Novo Selo

Ministri i Mbrojtjes, **z. Pirro Vengu**, ka vizituar bazën e **Grup Batalionit Shumëkombësh të NATO-s në Novo Selo, Bullgari**, ku shërben edhe një togë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të angazhimeve të vendit tonë në misionet e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Gjatë vizitës në bazë, ministri Vengu u njoh nga afër me kushtet e shërbimit dhe detyrat që kryejnë efektivet shqiptarë, duke vlerësuar profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin e tyre në përmbushjen e misionit shumëkombësh.

Përmes një postimi në rrjetet sociale, ministri i Mbrojtjes shprehu krenarinë për vlerësimin e dhënë nga komandanti italian i misionit, kolonel Mattia Scirocco, i cili theksoi se toga shqiptare luan një rol aktiv në detyrat e grupit, duke kontribuar përtej misionit të saj të paracaktuar operacional.

Sipas ministrit Vengu, ky vlerësim përbën një dëshmi të qartë të **profesionalizmit, përkushtimit dhe besueshmërisë së efektivëve shqiptarë** në çdo mision ku ata shërbejnë nën flamurin e NATO-s, si dhe të rolit gjithnjë e më aktiv të Shqipërisë në sigurinë kolektive.

“Në Bazën e Grup Batalionit Shumëkombësh të

● ***Shqipëria mbetet e gatshme të rrisë më tej prezencën dhe kontributin e saj në misionet e NATO-s, aty ku nevoja e kërkon, për të dëshmuar angazhimin e palëkundur ndaj sigurisë kolektive dhe për të forcuar përgatitjen operacionale të Forcave të Armatosura, krah për krah me aleatët.***

NATO-s në Novo Selo, Bullgari, isha krenar të dëgjoja nga komandanti italian i misionit se toga që përfaqëson Forcat e Armatosura të Shqipërisë luan një rol aktiv në detyrat e grupit, duke kontribuar përtej misionit të saj të paracaktuar. Kjo është një dëshmi e qartë e profesionalizmit, përkushtimit dhe besueshmërisë së efektivëve tanë në çdo mision ku shërbejnë nën flamurin e Aleancës”, - është shprehur ministri Vengu.

Në vijim, ministri theksoi se Shqipëria mbetet e

gatshme të rrisë më tej prezencën dhe kontributin e saj në misionet e NATO-s, aty ku nevoja e kërkon, për të dëshmuar angazhimin e palëkundur ndaj sigurisë kolektive dhe për të forcuar përgatitjen operacionale të Forcave të Armatosura, krah për krah me aleatët.

Angazhimi i togës shqiptare në Novo Selo konfirmon edhe një herë rolin aktiv të Shqipërisë si një partner i besueshëm dhe kontribuues në strukturat e Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Stërvitje e përbashkët me Forcat Speciale të SHBA-së në Zall-Herr

Forcat Speciale Shqiptare dhe Forcat Speciale të Shteteve të Bashkuara zhvilluan një stërvitje të përbashkët në Zall-Herr, e bazuar në skenarë realë për testimin e gatishmërisë për dislokim emergjent (EDRE).

Qëllimi i aktivitetit ishte forcimi i aftësive operative, rritja e ndërveprueshmërisë dhe konsolidimi i besimit mes aleatëve të NATO-s për të reaguar shpejt dhe efektiv ndaj krizave. Stërvitja përforcon bashkëpunimin ndërkombëtar dhe tregon përkushtimin e Forcave të Armatosura Shqiptare për të mbështetur sigurinë kolektive dhe gatishmërinë në misionet ndërkombëtare.



Batalioni i Xhenios ndërton urë metalike në Librazhd

Batalioni i Xhenios në kuadër të Komandës Mbështetëse vijon punën për ndërtimin e një ure metalike tip "Bailey" në fshatin Xhyre, bashkia Librazhd. Ura ka një gjatësi prej 39 metrash dhe kapacitet të shtuar prej 24 tonësh, duke ofruar një ndërhyrje të rëndësishme për komunitetin lokal. Ajo do të lehtësojë aksesin në shërbimet shëndetësore dhe arsimore, si dhe do të sigurojë lëvizjen e sigurt të mjeteve dhe këmbësorëve. Ky projekt tregon përkushtimin e Forcave të Armatosura për të mbështetur komunitetet civile dhe për të garantuar infrastrukturë të sigurt në zonat rurale.



KOMANDA MBËSHTETËSE 18 VITE NË FORMATIN E RI, 78 VITE HISTORI SHËRBIMI

Shtylla logjistike e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë

**Komanda Mbështetëse,
Forca që mban në këmbë misionin**

Komanda Mbështetëse, një nga strukturat më të rëndësishme dhe jetike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, shënon 18 vjet funksionim në formatin e saj aktual, duke mbartur njëkohësisht një trashëgimi historike që nis në vitin 1947. Ky përvjetor përbën një moment reflektimi institucional dhe krenarie profesionale për një strukturë që ka garantuar ndër vite funksionimin, gatishmërinë dhe suksesin e misioneve të FA-së, brenda dhe jashtë vendit.

Komanda Mbështetëse nuk është vetëm një hallkë logjistike, por një faktor strategjik, pa të cilin nuk mund të konceptohet veprimtaria operacionale e Forcave të Armatosura. Përkushtimi, profesionalizmi dhe përgjegjësia e personelit të saj janë themeli mbi të cilin ndërtohet qëndrueshmëria e misionit ushtarak.

18 vite modernizim dhe përgjegjësi

Që prej vitit 2007, Komanda Mbështetëse ka kaluar nëpër procese të vazhdueshme riorganizimi, modernizimi dhe përafrimi me standardet e NATO-s, duke u shndërruar në një strukturë funksionale, fleksibile dhe të aftë për t'u përballur me sfida komplekse.

HISTORIA DHE TRASHËGIMIA

Nga depoja e intendencës te komanda moderne logjistike

Rrënjët e Komandës Mbështetëse datojnë, më 14 nëntor 1947, me krijimin e Depos Qendrore të Intendencës, një strukturë themelore për ushtrinë e kohës. Në dekadat që pasuan, kjo strukturë ka njohur disa transformime, duke reflektuar zhvillimet historike dhe nevojat operacionale të Forcave të Armatosura.

Momente kyçe të historikut:

- 1948 – Magazinat Qendrore të Ushtrisë
- 1949 – Emërtimi me nr. reparti 8770
- 1993 – Bazat e Furnizimit të Ushtrisë
- 2000 – Komanda e Mbështetjes Logjistike
- 2003 – Brigada e Furnizimit
- 2007 – Krijimi i Komandës Mbështetëse

Këto etapa dëshmojnë një evolucion të pandërprerë, ku qëllimi ka qenë gjithmonë garantimi i mbështetjes së qëndrueshme për trupat.

Riorganizime në funksion të efijencës

Riorganizimet e mëvonshme (2010–2023) kanë synuar optimizimin e kapaciteteve, rritjen e efektivitetit dhe përshtatjen me kërkesat bashkëkohore të sigurisë, duke e bërë Komandën Mbështetëse një strukturë dinamike dhe funksionale.



MISIONI, DETYRAT DHE KONTRIBUTI SHOQËROR

një instrument të sigurisë kombëtare dhe humanitare.

Misioni: Mbështetje në çdo kohë dhe rrethanë

Misioni i Komandës Mbështetëse është të sigurojë mbështetje logjistike të plotë për trupat e luftimit dhe mbështetjes së luftimit, në kohë paqeje, krize dhe lufte, si dhe në operacione të emergjencave civile dhe misione ndërkombëtare.

Ky mision përfshin:

- furnizimin me të gjitha klasat (1–5);
- transportin dhe mirëmbajtjen;
- mbështetjen shëndetësore;
- administrimin e armatimit dhe municioneve;
- përmirësimin e infrastrukturës ushtarake.

Në shërbim të qytetarëve

Komanda Mbështetëse ka qenë vazhdimisht pranë popullsisë civile, duke ndërhyrë në:

- përmbajtje dhe fatkeqësi natyrore;
- shuarje zjarresh;
- vendosje urash "Bailey";
- çminime dhe asgjësim municionesh.

Ky angazhim e ka kthyer Komandën Mbështetëse në

FAKTORI NJERËZOR DHE E ARDHMJA

Njeriu në qendër të misionit

Forca reale e Komandës Mbështetëse qëndron te personeli i saj. Oficerë, nënoficerë, ushtarë dhe punonjës civilë, të trajnuar dhe të përkushtuar, garantojnë funksionimin e pandërprerë të strukturës.

Nëpërmjet trajnimit, arsimit dhe kualifikimit profesional, Komanda Mbështetëse përgatit personelin për:

- misione ndërkombëtare;
- operacione emergjence;
- specialitete logjistike dhe teknike.

Një strukturë që shikon përpara

Në përvjetorin e 18-të, Komanda Mbështetëse vijon rrugën e saj drejt modernizimit të mëtejshëm, rritjes së kapaciteteve dhe konsolidimit si një strukturë plotësisht e ndërveprueshme me NATO-n.

Komanda Mbështetëse është më shumë se një strukturë logjistike ajo është garancia e funksionimit të Forcave të Armatosura. Me 18 vite në formatin e ri dhe mbi 78 vite histori, ajo mbetet një shtyllë e sigurisë kombëtare dhe një shembull përkushtimi në shërbim të vendit.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Fundviti si moment reflektimi

Në fund të çdo viti, njeriu ndalet. Jo sepse koha ndalon, por sepse ndërgjegjja e kërkon këtë ndalesë. Është një çast reflektimi, një pauzë e domosdoshme përpara se të vazhdohet marshimi përpara. Në këtë ndalesë, njeriu sheh pas shpine barrën e muajve të kaluar, peshon humbjet dhe fitoret, numëron plagët dhe mësimet, dhe përpiqet të kuptojë nëse ka dalë më i fortë, më i vetëdijshëm dhe më njerëzor.

Dhjetori nuk është vetëm fundi i një viti kalendarik, ai është një moment bilanci moral dhe emocional. Ai na vë përballë vetes, përballë përgjegjësive tona individuale dhe kolektive, përballë mënyrës se si kemi zgjedhur të jetojmë, të shërbejmë dhe të reagojmë ndaj sfidave që na u shtrinë para syve.

Një vit sprovash dhe qëndrese

Dymbëdhjetë muajt që po lëmë pas nuk kanë qenë të lehtë. Shoqëria jonë është përballur me sprovë të vazhdueshme, humbje jetësh nga aksidente tragjike, dhunë brenda familjes dhe komunitetit, etj. Çdo lajm i hidhur ka lënë pas një boshllëk, një familje të copëtuar, një dhimbje që nuk shërohet lehtë.

Por përkundër dhimbjes, ky vit ka qenë edhe një vit qëndrese. Ashtu si në disiplinën ushtarake, ku qëndrueshmëria dhe vetëkontrolli janë thelbësore, edhe në jetën civile njeriu është thirrur të ruajë ekuilibrin, të mos dorëzohet dhe të vazhdojë përpara, edhe kur rruga është e vështirë.

Dhjetori dhe rituali i fundvitit

Që nga zanafilla e qytetërimit, njeriu ka festuar ndërrimin e viteve si një akt simbolik të rinisjes. Festat e fundvitit janë rituale që i japin kuptim kohës, e ndajnë atë në kapituj dhe i lejojnë shoqërisë të rigjejë frymëmarrjen e përbashkët.

Fishekzjarrët, tryezat festive, vizitat dhe urimet nuk janë vetëm zakone, ato janë shprehje të nevojës njerëzore për lidhje, për shpresë dhe për vazhdimësi. Në këtë kontekst, urimi nuk është thjesht një formulë mirësjelljeje, por një akt simbolik besimi në të ardhmen.

Urimi si pasqyrë e shoqërisë

Nga një këndvështrim sociologjik dhe psikologjik, urimet e Vitit të Ri mund të klasifikohen sipas kontekstit shoqëror dhe kulturor. Urimi që shkëmbehet në një familje ushtarake, ku mungesa dhe pritja janë pjesë e jetës, ka një peshë tjetër emocionale nga ai që shkëmbehet në rrethana më të qeta.

Megjithatë, një urim mbetet universal: "Gëzuar Vitin e Ri!". Ky urim kapërcen dallimet sociale, profesionale dhe kulturore. Ai shoqërohet shpesh me dhurata, veçanërisht në familje, duke forcuar lidhjet dhe ndjenjën e përkatësisë.

"Gjithë të mirat!" – një reflektim i domosdoshëm

Në vitet e fundit, krahas urimeve tradicionale, është përhapur gjerësisht shprehja "Gjithë të mirat!". Në dukje, ky është një urim i plotë dhe i sigurt. Por nëse e analizojmë më thellë, ai ngre një dilemë morale, a është e shëndetshme të dëshirohen "gjithë të mirat" për një individ të vetëm?

Historia na mëson se përqendrimi i të mirave pa masë dhe pa përgjegjësi ka prodhuar shpesh babëzi

Urimi, Festa dhe Shpresa: Nga vitet '90 deri në 2025, një udhëtim psikologjik dhe shoqëror i shpirtit shqiptar



dhe shkatërrim. Në këtë kuptim, një urim më i matur dhe më njerëzor do të ishte: "Çfarë t'ju dojë zemra!". Ky urim nuk nxit grumbullimin e verbër, por dëshirën e ndërgjegjshme për ekuilibrin mes detyrës dhe ndjenjës.

Festat nga vitet '90 deri në 2025

Vitet '90 në Shqipëri ishin vite varfërie materiale, por edhe shprese të madhe. Festat e fundvitit atëherë ishin të thjeshta: një tryezë modeste, pak ushqime tradicionale, një televizor dhe një familje e mbledhur rreth njëri-tjetrit. Gëzimi buronte jo nga bollëku, por nga ndjenja e ndryshimit dhe besimi se e ardhmja do të ishte më e mirë.

Në vitin 2025, realiteti është ndryshe. Teknologjia ka ndryshuar mënyrën e komunikimit, tryezat janë më të pasura dhe urimet qarkullojnë në pak sekonda përmes ekraneve. Por paradoksalisht, ndjenja e përbashkët shpesh është zbehur. Festojmë më shumë, por ndiejmë më pak.

Dhjetori si akt përgjegjësie dhe faljeje

Thelbi i dhjetorit nuk qëndron në dritat festive, por

në aktin e lëshimit dhe pajtimit. Është koha për të falur, për të reflektuar mbi gabimet dhe për të rivendosur ekuilibrin e brendshëm. Ashtu si në shërbimin ushtarak, ku disiplina dhe vetëkontrolli janë thelbësore, edhe në jetën civile falja kërkon forcë dhe pjekuri.

Duke u bërë më të dhembshur me veten dhe me të tjerët, ne çlirojmë energji për shpresën. Shpresa është forca më bazike e qenies njerëzore, ajo që na mban në këmbë edhe kur gjithçka tjetër lëkundet.

Nga vitet '90 deri në vitin 2025, nga tryezat e varfra por zemrat plot, tek bollëku material i shoqëruar me lodhje emocionale, një gjë mbetet e pandryshuar: nevoja për kuptim, për drejtësi dhe për njerëzi.

Për mua ky reflektim fundviti është një thirrje për përgjegjësi, solidaritet dhe forcë morale.

Ndoshta urimi më i vërtetë për vitin që vjen nuk është "Gjithë të mirat!", por: më shumë dinjitet, më shumë drejtësi, më shumë kujdes për jetën dhe më shumë guxim për të qenë njerëzorë në çdo rol që mbajmë.

Dhjetori nuk është vetëm një muaj; ai është një mundësi për të reflektuar mbi atë që kemi bërë, për të falur dhe për të rifilluar. Qëndresa shpirtërore, lidhja me të tjerët dhe shpresa që e bën jetën të vlefshme janë thesaret e vërteta të këtij muaji.



Sektorët që do të udhëheqin industrinë e mbrojtjes në vitin 2026: Industria globale, një epokë e re e sigurisë

Industria e mbrojtjes në nivel botëror po përjeton një transformim të thellë. Në vitin 2026, pritet që sektori të udhëhiqet nga teknologjitë e avancuara digjitale, inteligjenca artificiale, mbrojtja kibernetike, hapësira dhe dronët autonomë. Këto fusha nuk janë më thjesht shtesa në arsenalin tradicional, por po shndërrohen në shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Inteligjenca artificiale dhe analiza e të dhënave

Inteligjenca artificiale (AI) është bërë zemra e operacioneve moderne. Ajo përdoret për të analizuar miliona të dhëna në kohë reale, për të parashikuar lëvizjet e kundërshtarëve dhe për të optimizuar logjistikën. Në vitin 2026, pritet që çdo ushtri e madhe të ketë sisteme të integruara të AI-së, që ndihmojnë komandantët të marrin vendime më të shpejta dhe më të sakta. Për shembull, algoritmet mund të identifikojnë anomali në komunikimet e armikut ose të parashikojnë sulme kibernetike përpara se ato të ndodhin.

Mbrojtja kibernetike – fronti i padukshëm

Sulmet kibernetike janë bërë po aq të rrezikshme sa armët tradicionale. Një shtet mund të paralizohet pa u qëlluar asnjë plumb, thjesht duke sulmuar sistemet e tij digjitale. Për këtë arsye, mbrojtja kibernetike është prioritet absolut. Në vitin 2026, pritet që çdo ushtri të ketë një "komandë kibernetike" të dedikuar, e cila jo vetëm mbron, por edhe zhvillon kapacitete ofensive për të neutralizuar sistemet e kundërshtarëve.

Dronët dhe sistemet autonome

Dronët po revolucionarizojnë mënyrën e luftës. Nga dronët e vegjël për survejim deri te dronët e mëdhenj për transport dhe sulme, këto pajisje po zëvendësojnë misionet e rrezikshme për ushtarët. Në vitin 2026, pritet që dronët autonomë të jenë pjesë e përhershme e arseneleve moderne. Përparimi i teknologjisë ka bërë që dronët të jenë më të lirë, më të sofistikuar dhe më të lehtë për t'u përdorur, duke i dhënë avantazh edhe vendeve më të vogla.

Hapësira – arena e re strategjike

Satelitët ushtarakë përdoren për komunikim, navigim dhe survejim global. Kontrolli i orbitës është tashmë një garë mes fuqive të mëdha, dhe në vitin 2026 pritet të intensifikohet. Hapësira nuk është më thjesht një fushë shkencore, por një arenë strategjike, ku dominimi i informacionit dhe i teknologjisë është vendimtar. Kush kontrollon hapësirën, kontrollon komunikimin global dhe aftësinë për të parashikuar lëvizjet e kundërshtarëve.

Energjia e gjelbër dhe logjistika e qëndrueshme

Industria e mbrojtjes po përshtatet me tranzicionin energjetik. Automjetet elektrike, sistemet e furnizimit me energji të rinovueshme dhe teknologjitë e kursimit të energjisë po bëhen pjesë e strategjive ushtarake. Kjo jo vetëm që ul varësinë nga karburantet fosile, por edhe rrit fleksibilitetin e ushtrive në terren. Në vitin 2026, pritet që shumë ushtri të testojnë tanke dhe automjete të blinduara me motorë elektrikë, duke kombinuar fuqinë ushtarake me qëndrueshmërinë mjedisore.

Shqipëria – një kapitull i ri në mbrojtje

Në Shqipëri, viti 2026 shënon një moment historik. Për herë të parë, buxheti i mbrojtjes arrin në 2,12% të PBB-së, duke reflektuar një rritje prej 12% krahasuar me vitin 2025. Ky investim i madh tregon se mbrojtja është vendosur në qendër të prioritetëve kombëtare.

Aviacioni ushtarak

Ringritja e shkollës së aviacionit në Vlorë, në bashkëpunim me kompani izraelite, është një hap i madh drejt krijimit të kapaciteteve ajrore. Përveç përgatitjes së pilotëve dhe kontrollorëve ajrorë, parashikohet edhe krijimi i flotës së avionëve zjarrfikës për emergjenca civile. Kjo nismë e kthen Shqipërinë në një vend me kapacitete të qëndrueshme ajrore,



duke e bërë më të aftë për të reaguar ndaj krizave të brendshme dhe për të kontribuar në operacionet ndërkombëtare.

Industria vendase e mbrojtjes

Projekti "Made in Albania" synon të zhvillojë kapacitete prodhuese të brendshme, duke e bërë Shqipërinë jo vetëm konsumator, por edhe prodhues të pajisjeve ushtarake. Kjo nismë ka potencial të ndikojë pozitivisht në ekonominë kombëtare dhe të krijojë vende të reja pune. Për më tepër, zhvillimi i industrisë vendase e bën vendin më pak të varur nga importet dhe më të aftë për të përballuar krizën globale të furnizimeve.

Mbrojtja kibernetike

Shqipëria po investon gjithnjë e më shumë në sigurinë digjitale, duke e parë këtë fushë si një element kritik për mbrojtjen kombëtare. Sulmet kibernetike ndaj institucioneve publike kanë treguar se kjo është një fushë ku nevojitet vigjilencë e vazhdueshme. Në vitin 2026, pritet që Shqipëria të krijojë struktura të dedikuara për mbrojtjen kibernetike, duke e bërë këtë sektor një nga shtyllat kryesore të sigurisë kombëtare.

Emergjencat civile

Flota e re kombëtare për emergjencat është një tregues se mbrojtja nuk kufizohet vetëm në fushën ushtarake. Përballja me fatkeqësi natyrore, zjarre apo kriza humanitare po bëhet pjesë e pandashme e strategjisë së mbrojtjes. Kjo qasje e gjerë e bën mbrojtjen më gjithëpërfshirëse dhe më të lidhur me nevojat e qytetarëve.

Personeli ushtarak

Rritja e pagave dhe përmirësimi i kushteve të punës për ushtarakët është një tjetër element që tregon përkushtimin e shtetit ndaj forcave të armatosura. Motivimi i personelit është po aq i rëndësishëm sa pajisjet moderne, dhe në vitin 2026 pritet që Shqipëria të ketë një ushtri më të motivuar dhe më profesionale.

Rajoni dhe NATO, një kontekst i gjerë

Shqipëria nuk vepron e vetme. Si anëtare e NATO-s, ajo është pjesë e një strategjie më të gjerë rajonale dhe ndërkombëtare. Në Ballkan, ku tensionet historike

shpesh rikthehen, investimet në mbrojtje janë të lidhura ngushtë me stabilitetin politik dhe sigurinë e përbashkët.

NATO ka vendosur si standard që vendet anëtare të arrijnë pragun e 2% të PBB-së për mbrojtjen. Shqipëria jo vetëm që e ka arritur këtë, por e ka tejkaluar, duke u pozicionuar si një partner i besueshëm dhe aktiv. Ky fakt e rrit peshën e saj në vendimmarrjet e Aleancës dhe e bën një aktor më të rëndësishëm në rajon.

Ballkani mbetet një rajon i brishtë, ku siguria është e lidhur ngushtë me zhvillimet politike. Investimet në mbrojtje nuk janë vetëm për mbrojtjen kombëtare, por edhe për të kontribuar në stabilitetin e rajonit. Shqipëria, me kapacitetet e reja në aviacion, mbrojtje kibernetike dhe emergjenca civile, ka mundësinë të luajë një rol udhëheqës në bashkëpunimin rajonal.

Bashkëpunimi në fushën e emergjencave civile dhe mbrojtjes kibernetike po bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm. Shqipëria mund të ofrojë ekspertizë dhe kapacitete për të ndihmuar vendet fqinje, duke e pozicionuar veten si një qendër e besueshme e sigurisë në rajon.

Një vizion i ri për mbrojtjen

Në vitin 2026, industria globale e mbrojtjes do të udhëhiqet nga teknologjitë digjitale, mbrojtja kibernetike, dronët dhe hapësira. Ndërkohë, Shqipëria po hap një kapitull të ri me investime historike në aviacion, industri vendase dhe emergjenca civile. Ky është një moment ku mbrojtja nuk shihet më vetëm si një fushë ushtarake, por si një sistem i integruar që përfshin teknologjinë, ekonominë dhe sigurinë e qytetarëve.

Shqipëria, duke rritur buxhetin e saj dhe duke investuar në sektorë strategjikë, po tregon se është e gatshme të përballë me sfidat e kohës dhe të kontribuojë në sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Në këtë mënyrë, viti 2026 nuk është thjesht një vit i rritjes së shpenzimeve, por një vit i transformimit të vizionit të mbrojtjes, nga një koncept tradicional drejt një qasjeje moderne, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Ky shkrim synon të tregojë se mbrojtja nuk është më vetëm një çështje e ushtrisë, por një pjesë e pandashme e zhvillimit kombëtar dhe e rolit të Shqipërisë në botë. Në fund të fundit, siguria është themeli mbi të cilin ndërtohet prosperiteti i një kombi.

Kur profesionalizmi bëhet mision në shtypin ushtarak

Shtypi ushtarak shqiptar është një institucion i fjalës së shkruar që ka mbartur ndër vite përgjegjësi të shumta: informimin korrekt, dokumentimin historik, edukimin profesional dhe formimin e kulturës institucionale të Forcave të Armatosura. Ai ka qenë dhe mbetet një pasqyrë serioze e zhvillimeve ushtarake, por edhe një tribunë reflektimi për çështjet e sigurisë, mbrojtjes dhe interesit kombëtar. Në këtë mision, përveç punës së redaksisë, një rol thelbësor kanë pasur bashkëpunëtorët – autorë, studiues dhe analistë – të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm kanë pasuruar përmbajtjen e gazetës "Ushtria".

Ky material vjen si një portret i plotë dhe gjithëpërfshirës i bashkëpunëtorëve që, ndër vite, kanë dhënë një kontribut të çmuar në shtypin ushtarak: Bernard Zotaj, Zaho Golemi, Sali Onuzi, Nexhbedin Basha, Zeno Jahaj, Hysni Gjergji dhe Arben Dhuli. Secili prej tyre përfaqëson një profil të veçantë profesional, por të gjithë bashkohen nga serioziteti, korrektësia dhe ndjenja e përgjegjësisë ndaj fjalës së shkruar ushtarake.

Autorë që forcojnë kujtesën, mendimin dhe identitetin ushtarak

Prof. Asoc. Dr. (Mjeshtër i Madh) Bernard Zotaj është një nga studiuesit më të përkushtuar të historisë ushtarake, i cili i ka dhënë shtypit ushtarak dimension studimor dhe arkivor. Shkrimet e tij janë ndërtuar mbi kërkim të thelluar, përdorim të kujdesshëm të burimeve dhe analizë të matur. Ai ka kontribuar në ndriçimin e periudhave, strukturave dhe figurave të rëndësishme të historisë së ushtrisë shqiptare, duke e kthyer shtypin ushtarak në një hapësirë të besueshme dokumentimi dhe reflektimi historik. Përkushtimi i tij ndaj së vërtetës dhe korrektësia profesionale e bëjnë kontributin e Zotajt me vlerë afatgjatë.

Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi përfaqëson figurën e oficerit dhe studiuesit me formim të gjerë ushtarak dhe akademik, i cili ndërthur përvojën praktike me analizën strategjike dhe mendimin institucional. I formuar në akademi ushtarake brenda dhe jashtë vendit, si dhe i diplomuar në Histori dhe Diplomaci, ai sjell në shtypin ushtarak shkrime mbi sigurinë kombëtare, mbrojtjen, doktrinën ushtarake dhe zhvillimet strategjike. Kontributi i tij ka ndihmuar në rritjen e nivelit analitik të shtypit ushtarak dhe në forcimin e rolit të tij si platformë serioze mendimi profesional.

Kolonel (R) Sali Onuzi përfaqëson figurën e ushtarakut studiues dhe publicistit të përkushtuar, i cili ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në pasurimin e shtypit ushtarak me shkrime me karakter historik, dokumentues dhe reflektues. Si kolonel në rezervë, ai sjell në fjalën e shkruar përvojën e drejtpërdrejtë ushtarake të ndërthurur me ndjeshmëri kërkimore dhe respekt të veçantë për burimin historik.

Tematikat e trajtuara prej tij përfshijnë periudha dhe figura kyçe të historisë ushtarake shqiptare, si Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë dhe i Luftës Nacionalçlirimtare, komandantët e divizioneve, brigadat partizane dhe roli i tyre në çlirimin e vendit, si dhe portrete personalitetesh ushtarake, politike dhe akademike.

Kontributi i Sali Onuzit në shtypin ushtarak dallon për gjuhë të matur, korrektësi faktike dhe përgjegjësi profesionale. Ai i qaset historisë jo si narrativë e thjeshtë, por si proces analize dhe reflektimi, duke ndihmuar në ruajtjen e kujtesës ushtarake dhe në forcimin e kulturës institucionale. Përmes shkrimeve të tij, shtypi ushtarak pasurohet me materiale që shërbejnë si burim njohjeje dhe referimi për oficerët, studiuesit dhe lexuesin e interesuar.

Zeno Jahaj, analistit i gjeopolitikës dhe studiues i mendimit ushtarak, i formuar në institucionet më të rëndësishme të arsimit dhe trajnimit ushtarak brenda dhe jashtë vendit. I lindur në Mesaplik të Vlorës, në një familje me tradita patriotike, ai ka ndërtuar një karrierë të gjatë profesionale në komandim, shtab, diplomaci ushtarak dhe këshillim strategjik, duke mbajtur funksione të rëndësishme në Shtabin e Përgjithshëm, në përfaqësimin diplomatik të Shqipërisë jashtë vendit dhe në nivelet e larta të drejtimit të mbrojtjes. Me

Mes historisë, strategjisë dhe analizës: Bashkëpunëtorët e shtypit ushtarak



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI



KOLONEL (R) SALI ONUZI



ZENO JAHAJ



KOLONEL HYSNI GJERGJI IKSHU/AFA



KOLONEL ARBEN DHULI

Shtypi ushtarak shqiptar është një institucion i fjalës së shkruar që ka mbartur ndër vite përgjegjësi të shumta: informimin korrekt, dokumentimin historik, edukimin profesional dhe formimin e kulturës institucionale të Forcave të Armatosura. Ai ka qenë dhe mbetet një pasqyrë serioze e zhvillimeve ushtarake, por edhe një tribunë reflektimi për çështjet e sigurisë, mbrojtjes dhe interesit kombëtar

gradën kolonel, Jahaj ka sjellë në shtypin dhe studimet ushtarake përvojën e drejtpërdrejtë të një profesionisti të sigurisë.

Kontributi i tij studimor kulmon me librin "Gjeopolitika dhe Fuqia Ushtarake e Shqipërisë në Luftën e Ftohtë", një vepër me karakter doktrinor, e cila analizon në mënyrë të thelluar pozitën gjeopolitike dhe konceptin e mbrojtjes së Shqipërisë në një nga periudhat më komplekse të historisë ndërkombëtare.

I mbështetur në literaturë bashkëkohore dhe në përvojën personale ushtarake e diplomatike, libri përbën një prurje të rëndësishme për literaturën ushtarake, diplomatike dhe politike shqiptare, duke kontribuar në zhvillimin e mendimit strategjik dhe në forcimin e kulturës gjeopolitike në Forcat e Armatosura.

Kolonel Hysni Gjergji përfaqëson profilin e analistit të fushës së gjeopolitikës, duke sjellë në shtypin ushtarak një këndvështrim të gjerë mbi zhvillimet rajonale dhe ndërkombëtare që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë kombëtare. Shkrimet e tij trajtojnë raportet e forcave, interesat strategjike, sfidat e sigurisë dhe pozicionimin gjeopolitik të Shqipërisë dhe rajonit. Ai kontribuon në zgjerimin e horizontit analitik të shtypit ushtarak, duke ndihmuar lexuesin të kuptojë lidhjen mes zhvillimeve globale dhe misionit të Forcave të Armatosura. Kontributi i Gjergjit është i rëndësishëm për ndërtimin e një kulture strategjike dhe gjeopolitike brenda fjalës së shkruar ushtarake.

Kolonel Arben Dhuli është analist i fushës së logjistikës, një sektor thelbësor për funksionimin dhe efektivitetin e çdo strukture ushtarake. Shkrimet e tij në shtypin ushtarak trajtojnë çështje që lidhen me mbështetjen logjistike, planifikimin, menaxhimin e burimeve dhe rolin e logjistikës në garantimin e gatishmërisë operacionale. Ai e sjell këtë fushë me gjuhë profesionale dhe të kuptueshme, duke evidentuar rëndësinë strategjike që ka logjistika në suksesin e misioneve ushtarake. Kontributi i Dhulit pasuron shtypin ushtarak me analizë teknike dhe mendim praktik, duke e bërë atë më gjithëpërfshirës dhe më të lidhur me realitetin operativ.

Ky portret kolektiv i bashkëpunëtorëve të shtypit ushtarak dëshmon se cilësia dhe autoriteti i gazetës "Ushtria", ndërtohen mbi kontributin e autorëve të përkushtuar, që e shohin fjalën e shkruar si mision dhe përgjegjësi. Secili prej tyre, nga fusha e historisë, strategjisë, etikës, dokumentimit, gjeopolitikës dhe logjistikës, ka ndihmuar në ndërtimin e një shtypi ushtarak serioz, të besueshëm dhe me identitet të qartë.

Mirënjohje për ata që ndërtojnë fjalën ushtarake
Me rastin e festave të fundvitit, Redaksia e Shtypit Ushtarak shpreh mirënjohjen më të thellë për këta bashkëpunëtorë, duke i falënderuar për profesionalizmin, korrektësinë dhe përkushtimin e treguar ndër vite. Kontributi i tyre mbetet një vlerë e qëndrueshme për të tashmen dhe të ardhmen e gazetës "Ushtria".

Gëzuar festat dhe një Vit të Ri të mbarë!



GJENERAL (R) PIRO AHMETAJ
SENIOR EKSPERT PËR REFORMËN E SIGURISË
DHE MBROJTJES KOMBËTARE SI DHE
MARRËDHËNIET ME USA/NATO

Para një muaji, bashkë me paketën në tërësi u miratua edhe Buxheti i Mbrojtjes 2026. Në statusin e ekspertit për çështjet e reformës së mbrojtjes dhe NATO-s, përfshi planifikimin strategjik, në vijim gjeni “5 gjetje/arsye strategjike pse meriton të duartrokitet ky buxhet”:

Së pari, përtej paragjykimëve politike, por për peshën strategjike që mbart, këtë buxhet e gjej jo vetëm më të madhin në 35 vitet e fundit, por edhe si histori suksesi, për të cilin meritojnë duartrokitje Ministri si dhe stafi i MM. Shifrat flasin më fort se dhjetëra fjalime dhe mijëra fjalë, kështu: 58,9 miliardë lekë ose mbi 600 milionë €; rreth 2.12% të PBB, 12% më shumë se 2025; pesëfishin e 2015 si dhe 10 herë më shumë se 2001!

Përtej shifrave historike në vetvete, buxheti meriton po ashtu të duartrokitet, pasi i gjej shumë mirë të integruara dhe të mbështetura me buxhet: “Vizionin, Objektivat, Projektet, Përkushtimin si dhe Domosdoshmërinë kritike që ka Transformimi/Modernizimi i Sistemit (fuqisë ushtarake) të Mbrojtjes Kombëtare”!

Së dyti, buxheti i mbrojtjes 2026 meriton të përshëndetet, pasi çmoj se mirë adreson kërcënimet dhe ndryshimet radikale që ka pësuar mjedisi i sigurisë 4 vitet e fundit, si pasojë e: luftës së përgjakshme të Rusisë putiniste kundër sovranitetit të Ukrainës, njëherësh ndaj rendit global si dhe fuqisë ushtarake të Aleancës (USA/NATO/BE); përbaljes me shtetet dhe organizatat terroriste; rikthimit të frikshëm të gara e armatimeve; si dhe rikonfirmimit të qasjes së Presidentit Trump-2: “paqe nëpërmjet forcës”, deri te mirënjohja për nënshkrimin e ligjit të mbrojtjes kombëtare (NDAA), ku specifikisht: “konfirmohet mbështetja e SHBA-ve për integrimin e Kosovës në NATO/BE si dhe në dialogun me Serbinë, bazuar në njohje reciproke, pa ndryshim kufijsh apo shkëmbim terriroresh”!

Ndërsa dekadën e fundit janë përshkallëzuar përpjekjet dëshpëruese të Kremlinit për interesa gjeopolitike (përfshi hapjen e një fronti të ri luftime) në Ballkan, të cilat mbeten ndër rreziqet për paqen si dhe ardhmërinë euroatlantike të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjithsesi, kërcënimin nr. 1 për rajonin, përfshi RSH dhe Kosovën, mbeten demokracia fasadë dhe rikthimi i frikshëm të gara e armatimeve, të cilën e kryeson Serbia me mbi 3 miliard € shpenzime vjetore për armatime, avionë, raketa, dronë të gjeneratës së fundit, duke kërcënuar tërësinë territoriale të Kosovës, njëherësh interesat jetike të RSH, prezencën ushtarake të KFOR-it si dhe interesat gjeopolitike të USA/NATO në rajon.

Së treti, rritja e shpenzimeve të mbrojtjes për 2026 meriton të duartrokitet, pasi prioriteti thelbësor i tij është “modernizimi i kapaciteteve të FA-ve dhe rritja e fuqisë ushtarake të RSH”. Kështu, për herë të parë në 35 vite, 29 miliardë lekë (ose 50% e buxhetit vjetor) janë shpenzime për: “programet e modernizimit të armatimeve, mbrojtjes kibernetike dhe dixhitalizimit e njësive të luftimit; industrisë dhe infrastrukturave ushtarake; për helikopterët, anijet, stërvitjen si dhe projektet e përbashkëta me partnerët strategjikë”.

Po ashtu edhe projekti/ambicia “Made in Albania”, pra prodhimi i municioneve, dronëve e sistemeve antidron, pajisjeve personale, mjeteve të blinduara, etj., zë peshë të arsyetuar në këtë buxhet: “4,3 miliardë lekë janë parashikuar për emergjencat civile në mbrojtje

Pse meriton duartrokitje Buxheti i Mbrojtjes - 2026?

të jetës së qytetarëve, pronës së çdo familjeje dhe në çdo skaj të RSH; ngritja e dy qendrave rajonale për menaxhimin e emergjencave; dy avionë zjarrfikës për përbalimin e zjarreve si dhe investime në parandalim dhe reagim të shpejtë”.

Së katërti, edhe pse paketa e negociatave të anëtarësimit të RSH në BE nuk ka një kapitull të posaçëm për fuqinë ushtarake, në buxhetin 2026 konsiderohet zhvillimi i kapaciteteve operacionale për reagimin ndaj emergjencave civile, menaxhimin e krizave, sigurinë e infrastrukturave kritike dhe energjisë; sundimin e ligjit dhe monitorimin e kufijve, duke e shndërruar dhe integruar RSH në kontribuues aktiv për sigurinë, stabilitetin demokratik si dhe mbrojtjen e përbashkët europiane.

Së pesti, ndër prioritetet e buxhetit 2026 janë planëzuar edhe masat shtetërore për përmirësimin e besimit të shqiptarëve te institucionet, strukturat dhe agjencitë shtetërore të sigurisë. “Në zemër të këtij buxheti janë njerëzit me uniformë”, - theksoi ministri Pirro Vengu. Konkretisht, 13 miliardë (25%, shifër dinjitoze me standardet e NATO-s) do të shkojnë për paga më të larta, kushte më të mira jetese, standardet moderne të rekrutimit, karrierës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, pra për më shumë dinjitet për personelin e FA-së.

4 gjetje dhe këshilla strategjike për Reformën, përfshi Buxhetin e Mbrojtjes

1. Fillimisht, nga eksperiencia (dijeni zyrtare nga kolegët), konfirmoj se në 31 vendet e tjera të

NATO-s, strategjia, buxheti i mbrojtjes, programet e modernizimit, etj., janë produkt i diskutimeve dhe miratimit me konsensus në kuvend (Kongres & Senat në USA), çka i jep jo vetëm peshë vendimmarrëse balancave demokratike të pushteteve, por edhe legjitimitet sistemit të prokurimeve/shpenzimeve për rritjen e fuqisë së mbrojtjes kombëtare.

2. Duke përsëritur duartrokitjet e merituar për rritjen e buxhetit të mbrojtjes 2026, objektivin drejt 5% të GDP-së (mbi 1.2 miliard €), e gjej si legjitimitet ndërkombëtar (SHBA/NATO/BE), por edhe si oportunitet historik për të zhvilluar dhe ekspozuar fuqinë ushtarake, përfshi kapacitete deterrence (pra shkurajuese ose shpaguese) ndaj çdo vendi ose aleance sllave që kërcënon sovranitetin territorial dhe interesat gjeopolitike të RSH dhe Kosovës.

3. E çmoj po ashtu emergjencë fisnike dhe këshilloj ngritjen e një “Grupi të mençurish/Wise Group”, me personalitete/elita të gjerësisht pranuar, që përulen para flamurit, interesave kombëtare dhe përgjegjësi shtetërore, për ta jetësuar platformën: “2 shtete sovranë – 1 komb i vetëm”, e cila kontribuon edhe si balancë racionale për bashkëjetesën paqësore si dhe integrimin euroatlantik të rajonit.

4. Duke përsëritur mirënjohjen dhe respektin ndaj komunitetit të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare, do të sugjeroja, por edhe mbetem shpresëplotë, që sakrificat sublime, përkushtimi i dalluar, integriteti i spikatur si dhe përlësia fisnike e ushtarakëve, Policisë së Shtetit, Emergjencave Civile, inteligjencës, shëndetësisë, etj., do të trajtohen me dinjitetin që ata meritojnë.



USHTRIA SHQIPTARE, Garanci e Sigurisë dhe Nderit

Koha nuk matet vetëm me vite dhe data. Ajo matet me prova, sakrificë dhe gjurmë që mbeten. Në historinë e shtetit shqiptar, pak institucione kanë lënë gjurmë kaq të dukshme dhe të qëndrueshme sa Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ato kanë qenë dëshmitare dhe pjesëmarrëse aktive në çdo fazë të rrugëtimit tonë shtetformues, nga vitet e para të konsolidimit të shtetit, te sfidat e tranzicionit dhe deri në angazhimin dinjitoz në misionet ndërkombëtare të sigurisë.

Forcat e Armatosura nuk janë thjesht një strukturë ushtarake. Ato janë pasqyra e kohës, e ndryshimeve shoqërore, politike dhe strategjike që ka përjetuar vendi. Çdo brez ushtarakësh ka lënë gjurmën e vet, duke e ndërtuar këtë institucion mbi themele disiplinë, përkushtimi dhe besnikërie ndaj atdheut.

Ushtria si garant i ekzistencës shtetërore

Në momentet më të vështira të historisë, kur shteti shqiptar ka qenë i brishtë dhe i rrezikuar, Forcat e Armatosura kanë qenë një nga shtyllat kryesore të ruajtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial. Ato kanë përfaqësuar forcën e organizuar të shtetit, por edhe vullnetin për të mbijetuar si komb.

Në dekada, ushtria shqiptare ka kaluar nga një model mbrojtjeje statike, në një forcë moderne, fleksibile dhe të ndërveprueshme me aleatët. Ky transformim nuk ka qenë i lehtë. Ai ka kërkuar reforma të thella, sakrificë njerëzore dhe një ndryshim rrënjësor të mentalitetit ushtarak.

Nga izolimi te integrimi euroatlantik

Një nga gjurmët më domethënëse në kohë është rrugëtimi i Forcave të Armatosura drejt NATO-s. Anëtarësimi i Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut nuk ishte vetëm një akt politik, por një provë konkrete e profesionalizmit dhe besueshmërisë së ushtrisë shqiptare.

Sot, efektivët shqiptarë shërbejnë krah për krah me aleatët në misione ndërkombëtare, duke kontribuar në sigurinë kolektive dhe duke përfaqësuar me dinjitet flamurin kombëtar. Ky angazhim ka shndërruar Forcat e Armatosura nga një forcë mbrojtëse kombëtare, në një aktor aktiv të sigurisë globale.

Gjurmët e këtij transformimi lexohen në standarde, në doktrina, në trajnime dhe mbi të gjitha në mentalitetin e ushtarakut shqiptar të sotëm.

Ushtria dhe shoqëria një lidhje e pandashme

Një tjetër gjurmë e thellë në kohë është raporti i Forcave të Armatosura me shoqërinë civile. Ushtria shqiptare nuk ka qenë kurrë një institucion i shkëputur nga qytetari. Përkundrazi, në momentet më kritike – përmbajtje, zjarre, tërmete, emergjenca civile – ajo ka qenë në vijën e parë të ndihmës.

Ndërhyrjet për shpëtim jete, rindërtim infrastrukture, vendosje urash, evakuime dhe ndihmë humanitare kanë forcuar besimin e qytetarëve dhe kanë treguar se ushtria është jo vetëm mbrojtëse e territorit, por edhe mbrojtëse e jetës.

Kjo prani e vazhdueshme në shërbim të komunitetit ka lënë gjurmë të prekshme në kujtesën kolektive të shoqërisë shqiptare.

Faktori njerëzor gjurma më e fortë

Në qendër të çdo transformimi qëndron njeriu. Oficerët, nënoficerët, ushtarët dhe punonjësit civilë të Forcave të Armatosura janë ata që e mbajnë gjallë institucionin. Çdo uniformë mban brenda saj histori personale sakrifice, përgjegjësie dhe përkushtimi.



Gjurmët më të forta nuk janë gjithmonë të dukshme në dokumente apo struktura, por në etikën e shërbimit, në gatishmërinë për të vepruar, në besnikërinë ndaj misionit dhe atdheut.

Breza të tërë ushtarakësh kanë kontribuar që Forcat e Armatosura të jenë sot një institucion modern, i respektuar dhe i besueshëm.

Gjurmë që vazhdojnë të shkruhen

Historia e Forcave të Armatosura nuk është një kapitull i mbyllur. Ajo vazhdon të shkruhet çdo ditë, në stërvitje, në misione, në emergjenca, në proceset e modernizimit dhe në përgatitjen e brezave të rinj.

Në një realitet të sigurisë gjithnjë e më kompleks, ushtria shqiptare mbetet një garanci stabiliteti dhe një faktor kyç i sigurisë kombëtare dhe rajonale. Gjurmët e saj në kohë janë dëshmi se ky institucion ka ditur të përshtatet, të rritet dhe të ecë përpara, pa humbur thelbin e misionit të tij.

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë një histori e gjallë e shtetit shqiptar. Gjurmët që ato kanë lënë në kohë janë të gdhendura në sigurinë e vendit, në besimin e qytetarëve dhe në respektin e aleatëve.

Ato janë dëshmia se koha nuk e fshin shërbimin e ndershëm, por e forcon atë. Dhe sa herë që historia do të kthejë kokën pas, do të gjejë aty, në çdo moment kyç, ushtrinë shqiptare në shërbim të atdheut.



2025: Viti kur teknologjia ushtarake ndryshoi lojën globale

Bilanci i zhvillimeve teknologjike ushtarake gjatë vitit 2025

Viti 2025 ka qenë një vit i mbushur me transformime të thella në fushën e teknologjisë ushtarake. Në fund të këtij viti, tabloja globale e mbrojtjes paraqitet si një bilanc i qartë i risive, përparimeve dhe sfidave që kanë shënuar arenën ndërkombëtare. Ky bilanc është më i gjerë se kurrë, duke përfshirë jo vetëm inovacionet teknike, por edhe ndikimet strategjike, etike dhe politike që ato kanë sjellë.

Inteligjenca artificiale: Nga ndihmëse në vendimmarrëse

Në bilancin e vitit, inteligjenca artificiale ka kaluar nga një mjet ndihmës në një aktor kryesor. Sistemet e komandimit të bazuara në AI janë përdorur për të analizuar skenarë të shumtë në kohë reale, duke reduktuar gabimet njerëzore dhe duke rritur efikasitetin e operacioneve. Për herë të parë, disa ushtri kanë testuar komandantë virtualë, duke hapur një debat të madh etik mbi rolin e njeriut në vendimmarrjen ushtarake. Në SHBA, Pentagon-i ka prezantuar platforma të reja të inteligjencës artificiale që mund të parashikojnë lëvizjet e armikut me një saktësi të lartë, ndërsa Kina ka investuar në sisteme të ngjashme për të kontrolluar flotat e saj detare. Rusia, nga ana tjetër, ka fokusuar përdorimin e AI-së në mbrojtjen ajrore dhe në sistemet e raketave.

Dronët dhe robotika: Dominimi i fushës së betejës

Bilanci i vitit 2025 tregon se dronët kanë qenë ndër risitë më të spikatura. Modelet e reja janë më të vogla, më të shpejta dhe pothuajse të padukshme për radarët. Ato janë përdorur për survejim, operacione precize dhe misione të koordinuara në formacione të sofistikuara. Në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme, dronët kanë qenë vendimtarë në konfliktet e vazhdueshme, duke treguar se teknologjia e re ka ndryshuar balancën e fuqive. Robotët tokësorë dhe detarë kanë zëvendësuar trupat njerëzore në misione të rrezikshme, si çminimi i zonave apo patrullimi në terrene të vështira. Në Europë, ushtritë e NATO-s kanë testuar robotë të pajisur me armë jo-vdekjeprurëse për kontrollin e turmave dhe operacionet paqeruajtëse.

Energjia e drejtuar: Nga eksperiment në arsenal

Një tjetër pikë kyçe e bilancit është përdorimi i energjisë së drejtuar. Lazerët dhe sistemet elektromagnetike janë testuar me sukses për neutralizimin e raketave dhe dronëve armikë. Nga një koncept teorik, ato janë shndërruar në realitet praktik, duke u bërë pjesë e arsenalit të ushtrive më të mëdha. SHBA ka prezantuar sisteme lazer të vendosura në anije luftarake, ndërsa Izraeli ka testuar me sukses lazerë tokësorë për mbrojtjen e qyteteve nga raketat e shkurtra. Ky bilanc tregon se energjia e drejtuar është tashmë një pjesë e pandashme e mbrojtjes moderne.

Siguria kibernetike dhe rrjetet kuantike

Sulmet kibernetike kanë qenë një sfidë e vazhdueshme gjatë vitit, por bilanci tregon se ushtritë kanë investuar në sisteme të vetë-mësimit që neutralizojnë kërcënimet në kohë reale. Rrjetet kuantike kanë filluar të përdoren për transmetimin e të dhënave të koduara, duke e bërë pothuajse të pamundur ndërhyrjen e palëve të treta. Kina ka prezantuar rrjetin e saj kuantik për komunikimet ushtarake, ndërsa SHBA ka investuar në laboratorë të avancuar për të zhvilluar teknologji të ngjashme. Europa ka fokusuar përpjekjet në mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga sulmet kibernetike, duke e bërë sigurinë digjitale një prioritet të lartë.

Hapësira: fushë e re e rivalitetit

Bilanci i vitit 2025 nuk mund të kuptohet pa përmendur militarizimin e hapësirës. Satelitët e rinj të pajisur me sisteme mbrojtëse dhe sulmuese janë vendosur në orbitë, duke e kthyer hapësirën në një fushë të re betejë. SHBA ka prezantuar satelitë të aftë të neutralizojnë pajisjet e armikut, ndërsa Rusia ka testuar



sisteme anti-satelitore. Kina ka investuar në satelitë të rinj për survejim global, duke e bërë hapësirën një arenë të rivalitetit të hapur. Kontrolli i informacionit satelitor është bërë po aq i rëndësishëm sa kontrolli i territorit tokësor.

Bioteknologjia dhe trupat e së ardhmes

Në bilancin e vitit, bioteknologjia ka hyrë fuqishëm në fushën ushtarake. Ekzoskeletët e rinj kanë rritur qëndrueshmërinë dhe forcën e trupave, ndërsa studimet mbi përmirësimin gjenetik të ushtarëve kanë hapur debate të mëdha mbi etikën e përdorimit të trupit të njeriut si platformë teknologjike. SHBA ka testuar ekzoskeletë të lehtë për trupat e saj, ndërsa Kina ka investuar në pajisje që rrisin rezistencën fizike të ushtarëve. Europa ka fokusuar përpjekjet në pajisje mbrojtëse që reduktojnë lodhjen dhe rrisin sigurinë e trupave në misione të gjata.

Shqipëria përforcon arsenalin: Sistemi raketor "Javelin" hyn në përdorim

Në nivel kombëtar, Shqipëria ka hedhur hapat e saj të parë drejt modernizimit. Krijimi i Arkivit Qendror për dokumentacionin e tipologjisë së veçantë të armatimeve dhe pajisjeve ushtarake është një arritje e rëndësishme në bilancin e vitit. Ky proces ka lehtësuar qasjen e ekspertëve dhe ka krijuar një bazë të fortë për projekte të ardhshme.

Në bilancin e vitit 2025, një zhvillim i rëndësishëm për Shqipërinë ka qenë përfshirja e sistemit raketor amerikan "Javelin" në arsenalin e saj ushtarak. Marrja

e këtij sistemi përfaqëson një hap të madh drejt modernizimit të kapaciteteve mbrojtëse të vendit dhe rritjes së ndërveprimit me standardet e NATO-s.

"Javelin" është një sistem raketor i avancuar anti-tank, i njohur për aftësinë e tij të goditjes nga lart ("top attack") dhe për përdorimin e teknologjisë "fire-and-forget", që i lejon operatorit të lëshojë raketën dhe të zhvendoset menjëherë pa pasur nevojë për ndjekje të mëtejshme. Ky sistem është përdorur me sukses në konflikte të ndryshme dhe ka treguar efikasitet të lartë kundër mjeteve të blinduara.

Për Shqipërinë, integrimi i "Javelin" përfaqëson jo vetëm një përmirësim teknik, por edhe një sinjal të qartë për angazhimin e saj në mbrojtjen kolektive dhe në forcimin e kapaciteteve të saj luftarake në përputhje me aleatët strategjikë. Ky zhvillim është parë si pjesë e një strategjie më të gjerë për modernizimin e Forcave të Armatosura, krahas digjitalizimit të dokumentacionit teknik dhe përmirësimit të infrastrukturës logjistike.

Në këtë kontekst, viti 2025 ka qenë një vit ku Shqipëria ka bërë hapa konkretë drejt një ushtrie më të aftë, më të sigurt dhe më të integruar në sistemin e mbrojtjes euroatlantike.

Bilanci i vitit 2025 tregon një transformim të thellë të fushës ushtarake globale. Inteligjenca artificiale, dronët, energjia e drejtuar, siguria kibernetike, hapësira dhe bioteknologjia kanë kaluar nga ide në realitete të prekshme. SHBA, Kina dhe Rusia kanë udhëhequr garën e inovacionit, ndërsa Europa ka fokusuar përpjekjet në mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe në operacionet paqeruajtëse.

Nga informimi tek deformimi i realitetit

Media si pasqyrë e realitetit shqiptar

Në Shqipëri, media ka qenë gjithmonë një nga faktorët kryesorë që formëson mendimin publik dhe sjelljet shoqërore. Që nga vitet e tranzicionit, kur gazetat e para të pavarura u shfaqën si zëra të rinj të demokracisë, e deri tek televizioni kombëtar dhe më pas platformat online, media ka shërbyer si burim informacioni, por edhe si instrument ndikimi. Sot, në një treg mediatik të mbushur me televizione kombëtare, portale online dhe rrjete sociale, qytetarët marrin një sasi të madhe informacioni çdo ditë. Problemi është se ky informacion shpesh nuk është i filtruar, i verifikuar apo i balancuar, duke krijuar perceptime të gabuara dhe deformim të realitetit. Media nuk është thjesht pasqyrë e ngjarjeve, por shpesh është edhe krijuese e tyre, duke vendosur se cilat tema janë të rëndësishme dhe cilat duhen lënë në harresë.

Emisionet televizive dhe ndikimi i tyre

Televizionet kryesore në Shqipëri – si Top Channel, TV Klan, Vizion Plus – ofrojnë një gamë të gjerë programesh që kanë ndikim të madh tek publiku. Reality show-të janë shembulli më i qartë i ndikimit të medias vizive tek të rinjtë. Këto programe kanë audiencë rekord, por shpesh promovojnë modele sipërfaqësore të suksesit, ku fama arrihet përmes ekspozimit publik dhe jo përmes punës apo meritës. Ky fenomen ka krijuar një kulturë ku të rinjtë e shohin famën si qëllim kryesor të jetës, duke lënë në hije vlerat e punës së ndershme dhe përkushtimit. Emisionet e humorit dhe satirës, kanë rol argëtues, por shpesh banalizojnë problemet sociale dhe i kthejnë në shaka, duke ulur ndjeshmërinë e publikut ndaj çështjeve serioze. Ndërkohë, talk show-të politikë shpesh dominohen nga retorika e ashpër, përplasje verbale dhe mungesë argumentesh të thelluara. Kjo krijon një klimë polarizimi dhe mosbesimi tek të rinjtë ndaj politikës dhe institucioneve, duke i bërë ata më pak të interesuar për pjesëmarrje aktive në jetën publike.

Platformat online dhe rrjetet sociale

Në Shqipëri, rrjetet sociale si TikTok, Instagram dhe Facebook janë bërë burimi kryesor i informacionit për brezat e rinj. Përmbajtja e shpejtë dhe e pafiltruar e TikTok ka krijuar varësi digjitale. Të rinjtë kalojnë orë të tëra duke konsumuar video të shkurtra, shpesh pa vlerë edukative, duke ulur aftësinë për përqendrim dhe reflektim. Instagrami promovon një kulturë të imazhit perfekt, ku influencerët shfaqin jetën luksoze dhe konsumimin e produkteve të shtrenjta. Kjo krijon presion psikologjik tek të rinjtë dhe ndjenja inferioriteti, sepse ata e krahasojnë jetën e tyre reale me imazhet e idealizuara që shohin online. Portalet online, nga ana tjetër, fokusohen tek titujt sensacionalë dhe lajmet e rreme për të tërhequr klikime. Kjo ka sjellë një krizë besimi tek publiku, i cili



shpesh nuk di të dallojë informacionin e verifikuar nga manipulimi. Në këtë mënyrë, platformat online nuk janë vetëm burim informacioni, por edhe burim deformimi të realitetit.

Pasoja tek brezat e rinj

Ndikimi i mediave vizive dhe online në Shqipëri është i dukshëm tek formimi i brezave të rinj. Kultura e famës së shpejtë i mëson të rinjtë se sukcesi lidhet me ekspozimin publik dhe jo me punën e ndershme. Konsumimi i përmbajtjes sipërfaqësore ul aftësinë për të analizuar dhe për të reflektuar, duke krijuar një brez që shpesh nuk ka aftësi kritike për të dalluar informacionin e vërtetë nga manipulimi. Varësia digjitale është një tjetër problem i madh. Kalimi i tepërt i kohës në rrjete sociale lidhet me izolim, ankth dhe ulje të performancës akademike. Emisionet

konfliktuale dhe përmbajtja e rrjeteve sociale shpesh nxisin ndarje dhe gjuhë urrejtjeje, duke polarizuar shoqërinë dhe duke e bërë më të vështirë ndërtimin e një dialogu konstruktiv. Në këtë mënyrë, media nuk është vetëm burim informacioni, por edhe faktor që ndikon drejtpërdrejt në formimin e personalitetit dhe sjelljes së brezave të rinj.

Roli i medias në edukimin qytetar

Megjithëse dominon argëtimi komercial, media shqiptare ka potencial të madh për edukim qytetar. Dokumentarët, emisionet kulturore dhe programet edukative janë të pakta, por kur realizohen, kanë ndikim pozitiv. Për shembull, emisione që trajtojnë trashëgiminë kulturore, historinë apo çështjet sociale kanë treguar se publiku është i etur për përmbajtje cilësore. Problemi është mungesa e mbështetjes financiare dhe konkurrenca e fortë nga programet sensacionale, që shpesh marrin pjesën më të madhe të vëmendjes. Nëse media do të investonte më shumë në programe edukative, ajo do të mund të luante një rol të madh në formimin e një shoqërie më të ndërgjegjshme dhe më të përgjegjshme.

Etika dhe përgjegjësia mediatike në Shqipëri

Me fuqinë që ka, media shqiptare duhet të udhëhiqet nga parime të forta etike. Objektiviteti, verifikimi i fakteve, respekti për privatësinë dhe shmangia e gjuhës së urrejtjes janë shtylla që shpesh lihen pas dore. Shumë portale ndjekin vetëm klikimet dhe sensacionalizmin, pa marrë parasysh pasojat sociale. Kjo ka sjellë një krizë besimi tek publiku dhe ka ulur cilësinë e debatit publik. Për këtë arsye, edukimi mediatik duhet të jetë pjesë e formimit qytetar, që lexuesit të dinë të dallojnë informacionin cilësor nga ai manipulues. Vetëm në këtë mënyrë media mund të shërbejë si mjet edukimi dhe jo si instrument manipulimi.

Media në Shqipëri është një fuqi e madhe që mund të informojë, të edukojë dhe të frymëzojë, por shpesh përçon modele sipërfaqësore, varësi digjitale dhe polarizim shoqëror. Për të balancuar këtë ndikim, është e domosdoshme të investohet në programe edukative, dokumentarë cilësorë dhe fushata ndërgjegjësuëse, që i japin të rinjve mjete për të kuptuar dhe filtruar informacionin që konsumojnë. Në fund të fundit, media nuk është vetëm ajo që transmetohet, është ajo që ne zgjedhim të lexojmë, të besojmë dhe të përçojmë. Ndikimi i saj është i madh, por edhe përgjegjësia jonë si qytetarë është po aq e rëndësishme. Vetëm një media e lirë, e pavarur dhe e përgjegjshme mund të garantojë një shoqëri demokratike, të shëndetshme dhe të qëndrueshme.



Gëzuar

2026

JANUARY

S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

FEBRUARY

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28

MARCH

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

APRIL

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30		

MAY

S	M	T	W	T	F	S
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31						

JUNE

S	M	T	W	T	F	S
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

JULY

S	M	T	W	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

AUGUST

S	M	T	W	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31					

SEPTEMBER

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30			

OCTOBER

S	M	T	W	T	F	S
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

NOVEMBER

S	M	T	W	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30					

DECEMBER

S	M	T	W	T	F	S
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		